

UDHËZIM
Nr. 51, datë 1.12.2015

PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2015–2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikës 1/“ç”, të pikës 6 dhe pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015–2016”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Studentët e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2015–2016, të për zgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj, duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, deri në datën 4 dhjetor 2015 dokumentet e mëposhtme:

- a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) Vërtetim që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar 3 muajt e fundit;
- c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit;
- d) Fotokopjen të njëzuar me origjinalin të vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me kopje të njëzuar me origjinalin të diplomës ose të listës së notave;
- e) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri;
- f) Kopjen e njëzuar të origjinalit të lejeqëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;
- g) *Curriculum Vitae*;
- h) Deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integritit dhe Projekteve i kërkon aplikantit plotësimin e tij brenda datës 9 dhjetor 2015. Drejtoria e Integritit dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i

kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të IAL-ve. Kërkesat e aplikantëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 15 dhjetor 2015, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj, brenda datës 23 dhjetor 2015, paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të përfunduar procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës 28 dhjetor 2015, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar. AKP-i përgatit dhe u përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 15 janar 2016.

7. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla